

Home > Aktualitet > Kapet me armë zjarri në banesë, arrestohet 25-vjeçari në Korçë

AKTUALITET

Kapet me armë zjarri në banesë, arrestohet 25-vjeçari në Korçë

Arrestohet 25-vjeçari në Korçë pasi policia i gjeti në banesë një armë zjarri tip pistoletë.



Arma e zjarrit e gjetur në banesë

18 Korrik, 2019 12:55

Korçë- Në prangat e policisë së Korçës ka rënë një 25-vjeçar pasi gjatë kontrollit në banesë iu gjet një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

Nga policia është arrestuar Xh.B, 25 vjeç, banues në fshatin Porodinë, Korçë.

Njoftimi i policisë:

Korçë

Finalizohet operacioni policor i koduar “Porodina”

Goditet një rast i armëmbajtjes pa leje .

Arrestohet në flagrancë një shtetas pasi gjatë kontrollit në banesë iu gjet një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](https://dosja.al)

Në vijim të punës për rritjen e parametrave të sigurisë, shërbimet e Komisarariatit të Policisë

Korçë, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor “Porodina”, si rezultat i të cilit u bë bërë kapja dhe arrestimi në flagrancë të shtetasit Xh.B, 25 vjeç, banues në fshatin Porodinë, Korçë.

Në bazë të informacioneve të siguruara në rrugë policore se ky shtetas qarkullonte me armë zjarri në automjet, shërbimet e policisë e kanë lokalizuar në lagjen nr.1, në Korçë dhe kanë ndaluar për kontroll automjetin që drejtohej nga ky shtetas, ku gjatë kontrollit fizik dhe në automjet Policia gjeti dhe sekuestroi një shkop gome.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij, Policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë me fishekë, të cilat i mbante pa leje.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për veprime të mëtejshme.

J.V/Dosja.al

DR LIGHT

ETIKETA: #armëmbajtje pa leje në korçë #arrestohet 25 vjeçari në korçë

2

SHARES



Previous article

Pas videos erotike sheiku i ofron 50 mijë euro për një natë, gazetarja seksi vihet në mëdyshje (FOTO)

Next article

“A ka frikë presidenti nga Komisioni Hetimor?”, përgjigjja diplomatike e Metës

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo